

Koronavirusi (COVID-19): Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara

Portali për personat me aftësi të kufizuara

Portali për Personat me Aftësi të Kufizuara ofron informacione dhe referime për personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për ndihmë për shkak të koronavirusit. Ajo gjithashtu mund të ndihmojë familjet, kujdestarët dhe punëtorët që u japin mbështetje.

Ju mund të kontaktoni portën për personat me aftësi të kufizuara në **1800 643 787**.

Portali për personat me aftësi të kufizuara është në dispozicion prej të hënës deri të premten nga ora 8 në mëngjes deri në orën 8 në mbrëmje. Nuk është në dispozicion gjatë fundjavave apo festave publike kombëtare.

Nëse jeni të shurdhër, ose keni një dëmtim dëgjimi apo në të folurit, mund të telefononi Shërbimin Kombëtar Rele (konvertim/Relay) në **133 677**.

Nëse keni nevojë për mbështetje në një gjuhë tjetër, mund të përdorni Shërbimin e Përkthimit dhe Interpretimit (TIS National) duke:

- thirrur Portalin për Personat me Aftësi të Kufizuara në **1800 643 787** dhe duke kërkuar një përkthyes, ose

- duke thirrur TIS në **131 450** dhe kërkoni të lidheni me Portalin për Personat me Aftësi të Kufizuara në **1800 643 787**.

Pse të telefononi Portalin për Personat me Aftësi të Kufizuara?

Portali për Personat me Aftësi të Kufizuara është ngritur në mënyrë që të mund të bisedoni me dikë që i kupton nevojat tuaja.

Nëse ndiheni vetëm, i hutuar ose i shqetësuar për koronavirusin ose nëse doni të diskutoni situata specifike që prekin njerëzit me aftësi të kufizuara, ne mund të ndihmojmë. Për shembull, nëse punonjësi juaj mbështetës nuk ka ardhur, ofruesi juaj ka ndaluar shërbimet ose nëse është e vështirë për ju të merrni ushqim, medikamente ose sende të tjera esenciale.

Porta për Personat me Aftësi të Kufizuara do t'ju ofrojë informacione të qarta dhe me fakte të kontrolluara, dhe do t'ju transferojë në shërbime që mund t'ju ndihmojnë më tej, siç janë shërbimet e këshillimit ose avokimit, nëse dëshironi.

Burime të qasshme dhe të përkthyer në lidhje me koronavirusin

Një sërë burimesh të qasshmerreth koronavirusit, duke përfshirë Easy Read dhe Auslan, janë në dispozicion në www.disabilitygateway.gov.au.

Ju gjithashtu mund të gjeni informacione rreth koronavirusit të përkthyer në 63 gjuhë në [uebfaqen e Departamentit të Punëve të Brendshme](#) .

Informacionet e fundit

Për këshillat më të fundit shëndetësore dhe zyrtare dhe përditësime rreth koronavirusit në Australi, duke përfshirë masat që Qeveria dhe shteti ose territori juaj po vendosin për të zvogëluar përhapjen e virusit, vizitoni [uebfaqen e qeverisë së Australisë](#) .

Si të parashtroni një ankesë

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të ankohen për shërbimet që ata marrin. Nëse keni shqetësim në lidhje me mbështetjet ose shërbimet tuaja aktuale, mund të kontaktoni:

- [Komisioni për Cilësi dhe Mbrojtje NDIS](#) — në qoftë se ju keni një shqetësim në lidhje me cilësinë ose sigurinë e mbështetjes ose shërbimeve që merrni nga NDIS
- [Agjencia Kombëtare e Sigurimit për Personat me Aftësi të Kufizuara\(NDIA\)](#) — nëse keni shqetësim në lidhje me planin tuaj të NDIS ose të NDIA
- [Linja Direkte Kombëtare për Abuzim dhe Neglizhim](#) — për raportimin e abuzimit dhe neglizhimit të personave me aftësi të kufizuara
- [Shërbimi për Referime dhe për Zgjidhje të Ankesave](#) — nëse keni shqetësime për shërbimet që merrni përmes Shërbimeve të Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara (DES), Iniciativat Australiane për Personat me Aftësi të Kufizuara (ADE) dhe/ose Shërbimeve për Avokim për Personat me Aftësi të Kufizuara
- [Linja për Ankesa DSS](#) — nëse keni shqetësim për ndonjë ofrues tjetër të financuar nga Departamenti i Shërbimeve Sociale.

Më shumë informacione

Qeveria Australiane financon një sërë shërbimesh dhe programesh për njerëzit me aftësi të kufizuara. Për të gjetur se kë tjetër mund të flisni ose për më shumë informacione vizitoni

www.disabilitygateway.gov.au

Rifreskuar së fundi herë në shkurt 2021.